



DEKRET PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Nr. i Dekretit: 179 /2022

Presidentja e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 18 dhe nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), nenit 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare (GZ, Nr. 28, 16 dhjetor 2011), nenit 4 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 26, 02 qershor 2008), si dhe duke marrë parasysh kërkesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës drejtuar Presidentes, më datë 10.06.2022 (Nr. Prot: 01/93-747-01-22):

D E K R E T O N

Ratifikimin e Marrëveshjes lidhur me bashkëprodhimin kinematografik, e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, më 21.05.2022 dhe e pranuar në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës, më 10.06.2022.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Vjosa Osmani – Sadriu

Presidente e Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 15 .06 .2022

Dekreti t'i dërgohet:

- Kryetarin të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- a/a.

MARRËVESHJE

NDËRMJET

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË FRANCËS

**LIDHUR ME BASHKËPRODHIMIN KINEMATOGRAFIK
(SHTOJCË E BASHKANGJITUR)**

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Francës, në vijim të emërtuarit si « Palët »;

Duke marrë parasysh Konventën e UNESCO-s për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore, të miratuar në Paris më 20 tetor 2005, e së cilës Palët ndajnë parimet dhe objektivat, në të cilat Republika e Francës është palë, dhe që Republika e Kosovës e merr përsipër ta ratifikojë kur të bëhet anëtare e UNESCO-s;

Duke marrë parasysh synimin e përbashkët të Palëve për të forcuar bashkëpunimin në fushën e kinematografisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Francës, si dhe të rrisin trashëgiminë e tyre të përbashkët kinematografike;

Duke marrë parasysh nevojën për të përmirësuar kornizën ligjore të bashkëpunimit të tyre kinematografik dhe duke marrë parasysh rregullat e industrisë kinematografike në fuqi në Kosovë dhe në Francë;

Pajtohen si më poshtë në vijim:

I. BASHKËPRODHIM

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi « vepër kinematografike » nënkupton veprat kinematografike të të gjitha kohëzgjatjeve dhe në të gjitha formatet, të cilido qoftë zhanri (fiksion, i animuar, dokumentar), në përputhje me dispozitat legjislative dhe normative të secilës prej Palëve, për të cilat shfaqja e parë bëhet në sallat e shfaqjeve kinematografike.
2. Termi « bashkëprodhim kinematografik » nënkupton masat e marra nga bashkëprodhuesit që synojnë realizimin e një vepre kinematografike siç përcaktohet në pikën 1 të këtij neni.
3. Termi « bashkëprodhues » nënkupton kompaninë e prodhimit kinematografik e themeluar në territorin e Republikës së Kosovës, ose në territorin e Republikës së Francës. Konsiderohen se janë të themeluara në Kosovë ose në Francë kompanitë që aktualisht kryejnë aktivitet me anë të një instalimi të qëndrueshëm në njërin nga këto dy shtete, selia e regjistruar e të cilave ndodhet në shtetin e njëjtë përkatës, në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian ose në një shtet që është palë në Marrëveshjen e Zonës Ekonomike Evropiane.
4. Termi « autoritet kompetent » ka të bëjë me:
 - a. Qeverinë e Republikës së Kosovës: Qendra Kinematografike e Kosovës;
 - b. Qeverinë e Republikës së Francës: Centre national du cinéma et de l'image animée.

Neni 2

1. Veprat kinematografike të prodhuara në bashkëprodhim në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohen si vepra kinematografike kombëtare në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e shtetit të secilës palë.
2. Veprat e bashkëprodhimit kinematografik të prodhuara sipas kësaj Marrëveshjeje do të kenë qasje të plotë, me të drejta të plota, në territorin e Shtetit të secilës Palë, në përparësitë që rrjedhin nga dispozitat në lidhje me industrinë kinematografike në fuqi në territorin e Shtetit të secilës Palë. Autoriteti kompetent i secilës Palë i komunikon autoritetit kompetent të Palës tjetër listën e teksteve në lidhje me këto përparësi. Nëse tekstet në lidhje me këto përparësi ndryshohen, në çfarëdo mënyre nga njëra ose tjetra Palë, autoriteti kompetent i Palës së tanguar e merr përsipër t'ia komunikojë përmbajtjen e këtyre ndryshimeve autoritetit kompetent të Palës tjetër përkatëse.
3. Këto përparësi i jepen vetëm bashkëprodhuesit të vendosur në territorin e shtetit të Palës që i jep të njëjta.
4. Për t'u pranuar sipas kësaj Marrëveshjeje, një vepër kinematografike duhet të jetë e bashkëprodhuar nga prodhuesit e të dyja Palëve.
5. Kërkesat e pranimit në statusin e bashkëprodhimit duhet të jenë në përputhje me procedurat e parashikuara për këtë qëllim nga Palët dhe të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.
6. Autoritetet kompetente të të dyja Palëve do t'i japin veprës kinematografike të prodhuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje statusin e bashkëprodhimit.
7. Autoritetet kompetente të të dyja Palëve i komunikojnë njëra-tjetrës të gjitha informacionet në lidhje me dhënien, refuzimin, modifikimin ose tërheqjen e kërkesave për pranim në statusin e bashkëprodhimit.
8. Përpara se të refuzohet një kërkesë për pranim në statusin e bashkëprodhimit, autoritetet kompetente e të dyja Palëve duhet të këshillohen me njëra-tjetrën.
9. Kur autoritetet kompetente të të dyja Palëve i kanë dhënë veprës kinematografike statusin e bashkëprodhimit, ky status nuk mund të hiqet më pas, përveçse me vendim të përbashkët të autoriteteve kompetente.

Neni 3

1. Për të fituar statusin e bashkëprodhimit, veprat kinematografike duhet të prodhohen nga bashkëprodhues me organizim të mirë teknik e financiar dhe me përvojë profesionale.
2. Pjesëtarët e stafit artistik dhe teknik që marrin pjesë në bashkëprodhimin kinematografik duhet të jenë ose të kombësisë kosovare ose franceze, apo të jenë shtetas të një shteti tjetër anëtar i Bashkimit Evropian ose të një shteti palë në Marrëveshjen e Zonës Ekonomike Evropiane.

Personat që nuk kanë shtetësinë e shteteve të sipërpërmendura, posedues të lejes së qëndrimit francez ose kosovar apo të një dokumenti ekuivalent të lëshuar nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian ose një shtet tjetër anëtar në marrëveshjen e Zonës Ekonomike Evropiane, njësohen në këtë aspekt me shtetasit e Republikës së Kosovës apo të Republikës së Francës.

3. Përjashtimisht, autoritetet kompetente të të dyja Palëve mund të pranojnë bashkërisht pjesëmarrjen e bashkëpunëtorëve artistikë dhe teknikë, që nuk plotësojnë kushtet e kombësisë ose të vendbanimit, siç përshkruhen në pikën 2 të këtij neni.
4. Pamjet e realizuara në studio duhet të bëhen në territoret e shteteve të bashkëprodhuesve.
5. Përjashtimisht, autoritetet kompetente të të dyja Palëve mund të lejojnë me marrëveshje të ndërsjellë, që pamjet e realizuara në mjedise natyrore të bëhen në territorin e një shteti që nuk është palë në këtë Marrëveshje, nëse skenari i veprës kinematografike e kërkon një gjë të tillë.
6. Paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni zbatohen në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian, që kanë të bëjnë me ligjin e ndihmës shtetërore të zbatueshme në fushën e kinemasë, veçanërisht siç përcaktohet në Komunikatën e Komisionit për ndihmën shtetërore në favor me veprat kinematografike dhe veprat e tjera audiovizive (2013/C 332/01) botuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian më 15 nëntor 2013.

Neni 4

1. Përqindja e kontributeve përkatëse të bashkëprodhuesve të secilës Palë mund të sillet nga njëzet (20) në tetëdhjetë (80) për qind të buxhetit të përgjithshëm të bashkëprodhimit.
2. Autoritetet kompetente të Palëve mund të lejojnë, në raste të veçanta dhe pas marrëveshjes ndërmjet tyre, që shuma e kontributit të përmendur në pikën 1 të këtij neni të mund të reduktohet në dhjetë (10) për qind të buxhetit të përgjithshëm të bashkëprodhimit.
3. Autoritetet kompetente të Palëve sigurojnë që pjesëmarrja teknike dhe artistike e bashkëprodhuesve të secilës Palë të jetë proporcionale me kontributin përkatës financiar. Përjashtimet mund të pranohen me marrëveshje ndërmjet autoriteteve kompetente të të dyja Palëve.

Neni 5

Që një vepër kinematografike të jetë e pranueshme në përfitim të kësaj Marrëveshjeje, secili nga bashkëprodhuesit e saj duhet të jetë bashkëpronarë.

Neni 6

Palët do të lehtësojnë, në përputhje me rregullat e tyre kombëtare dhe angazhimet e tyre përkatëse ndërkombëtare, importin dhe eksportin e materialit të nevojshëm për prodhimin e veprave kinematografike në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Çdo Palë do të përpiqet, në përputhje me rregullat dhe angazhimet e sipërpërmendura, të lehtësojë lëvizjen dhe qëndrimin në territorin e vendit të saj personelit artistik dhe teknik, që bashkëpunon në bashkëprodhimin kinematografik.

Neni 7

1. Autoritetet kompetente të të dyja Palëve do të shqyrtojnë çdo dy vjet nëse sigurohet ekuilibër ndërmjet kontributeve për veprat e prodhuara në bashkëprodhim.
2. Ekuilibri i përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet të arrihet, si në lidhje me kontributet artistike e teknike, ashtu edhe me kontributet financiare. Ky ekuilibër është vlerësuar nga Komisioni i Përbashkët i parashikuar në nenin 11.
3. Për të kontrolluar nëse është siguruar ekuilibri, autoritetet kompetente hartojnë një përmbledhje të të gjitha mjeteve të mbështetjes dhe financimit.
4. Në qoftë se shfaqet ndonjë çekuilibër, Komisioni i Përbashkët shqyrton mjetet e nevojshme për të rivendosur ekuilibrin dhe merr të gjitha masat që i gjykon të nevojshme për këtë qëllim.

Neni 8

Kreditët, trejlerët, publikimet dhe materiali reklamues i veprës kinematografike duhet të përmendin shprehimisht bashkëprodhimin kosovaro-francez ose franko-kosovar.

Neni 9

Shpërndarja e të hyrave nga vepra e bashkëprodhuar përcaktohet nga bashkëprodhuesit e saj.

Neni 10

1. Autoritetet kompetente të Palëve mund të pranojnë, me marrëveshje të ndërsjellë, që veprat kinematografike të mbuluara nga kjo Marrëveshje të mund të bashkëprodhohen me një ose më shumë prodhues në shtetet me të cilat secila Palë ka lidhur marrëveshje në fushën e bashkëprodhimit kinematografik.
2. Autoritetet kompetente të të dyja Palëve do të shqyrtojnë rast pas rasti pranimin në statusin e bashkëprodhimit të veprave kinematografike të përshkruara në pikën 1 të këtij neni.

II. KOMISIONI I PËRBASHKËT

Neni 11

1. Për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, krijohet një Komision i përbashkët, i përbërë nga një numër i barabartë përfaqësuesish të autoriteteve kompetente dhe ekspertësh të caktuar nga secila Palë.
2. Komisioni i përbashkët mblidhet në parim çdo dy vjet, në mënyrë alternative në Kosovë dhe në Francë.
3. Komisioni i Përbashkët mund të mblidhet gjithashtu me kërkesë të njërit prej autoriteteve kompetente, veçanërisht në rast të një ndryshimi në legjislacionin kombëtar në lidhje me kinematografinë ose në rast se funksionimi i Marrëveshjes has në vështirësi të një rëndësie

të veçantë në zbatimin e saj, veçanërisht në rast të çekuilibri të përcaktuar në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 12

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimit ose negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve.

Neni 13

1. Pala Kosovare zotohet që në kuadër të anëtarësimit të ardhshëm në Organizatën Botërore të Tregtisë, të mos marrë asnjë angazhim për liberalizimin e sektorit audioviziv dhe të vendosë përjashtim nga klauzola e kombit më të favorizuar në lidhje me Marrëveshjet e Bashkëprodhimit kinematografik me shtetet e treta.
2. Në rast të mospërbushjes së këtij zotimi nga Pala kosovare, Pala franceze mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje. Zbatohen detyrimisht kushtet e parashikuara në Nenin 14, pika 3. Megjithatë, në një rast të tillë, Marrëveshja pushon të jetë e vlefshme një ditë pas datës së marrjes së njoftimit për përfundimin e së njëjtës.

Neni 14

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi tridhjetë ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit nëpërmjet kanalit diplomatik, me të cilin Palët informojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet në çdo kohë, me shkrim, me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Palëve. Ky modifikim është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.
3. Kjo Marrëveshje është lidhur për një periudhë të pacaktuar. Secila nga dy Palët mund ta denoncojë këtë Marrëveshje, në çdo kohë, me njoftim me shkrim të dërguar nëpërmjet kanalit diplomatik. Në këtë rast, Marrëveshja pushon të jetë e vlefshme gjashtë (6) muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi. Përfundimi i Marrëveshjes nuk vë në pikëpyetje të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me projektet e ndërmarra sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur Palët vendosin ndryshe.

NëKarë....., me 21 maj 2022, në dy ekzemplarë origjinal, në gjuhën shqipe dhe frënge, të dy tekstet janë njëloj autentikë.

Për Qeverinë
e Republikës së Kosovës

HASRULLAH ÇEKU
MINISTËR I KULTURËS
RINËSË DHE SPORTIT

Për Qeverinë
e Republikës së Francës

DOMINIQUE BOUTONNET

PRESIDENTI I CNC-SË

SHTOJCË

Procedura e aplikimit

Bashkëprodhuesit e secilës prej dy Palëve, për të marrë statusin e bashkëprodhimit, duhet t'i bashkëngjisin aplikimit të tyre për pranim, përpara fillimit të xhirimeve dhe t'i paraqesin autoritetit kompetent të Palës së cilës ata i përkasin, një dosje që përmban:

- një kopje të kontratave që vërtetojnë zinxhirin e plotë të së drejtës së autorit;
- verzioni përfundimtar i skenarit;
- informacion mbi hyrjet teknike dhe artistike të bashkëprodhuesve;
- planin e detajuar të punës;
- një pro-faturë dhe një plan të detajuar financimi;
- kontratën e nënshkruar të bashkëprodhimit.

Autoriteti kompetent i Palës me pjesëmarrjen e pakicës jep miratimin e tij vetëm pasi të ketë marrë mendimin e autoritetit kompetent të Palës me pjesëmarrjen shumicës.